



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 44/2016

Prishtinë, më 14.1.2016, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Sasha Milosavleviq, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Shefki Kastrati- NDI; Visar Rushiti dhe Berat Thaçi -GAP; Visar Berisha -INDEP; Dren Ajeti- GSJP; Fjolla Uka, Kaltrina Ahmeti dhe Albert Krasniqi- KDI dhe Sylejman Blaku- “Kosova Sot”.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.12.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2015 dhe orientimet kryesore për vitin 2016;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.12.2015

Procesverbali i mbledhjes së datës 21.12.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2015 dhe orientimet kryesore për vitin 2016

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, i njoftoi anëtarët e Komisionit se Njësia për Mbështetjen e Komisionit, e ka përgatitur Raportin e punës për vitin 2015, duke u bazuar në aktivitetet e shumta që ka pasur Komisioni gjatë vitit 2015. Ai tha se kemi pasur aktivitete dinamike dhe Plani i punës për vitin 2015, është realizuar në tërësi, me përjashtim të një çështjeje që mbetet për vitin 2016, që është takimi me Agjencinë e Statistikave dhe disa projektligje nga fusha e energjisë që nuk janë proceduar nga Qeveria. Me këtë rast, kryetari Mustafa paraqiti në formë statistikore aktivitetet dhe punët e realizuara të Komisionit gjatë vitit 2015, si vijon: numri i mbledhjeve të mbajtura 43; projektligje të shqyrtuara dhe të amendamentuara 10; dëgjime publike 6; monitorime të ligjeve 2; shqyrtime të raporteve vjetore të institucioneve raportuese 4; 145 amendamente; 60 rekomandime etj. Ndërsa, orientimet kryesore për vitin 2016, duhet të diskutohen në planin e punës që do ta hartojmë metodologjinë dhe formën e punës, që do ta ndjekim për të qenë sa më efikas, sidomos në rishikimin e rekomandimeve të nxjerra nga Komisioni dhe të miratuara nga Kuvendi, se sa po zbatohen. Sa i përket temave që do t'i shqyrtojmë, të fokusohemi më shumë në monitorimin e rekomandimeve, si për kontest të bizneseve dhe për industrinë e qumështit. Në vitin 2016, do t'i mbikëqyrim 2-3 ligje që janë kyçe për zhvillimin ekonomik. Po ashtu, duhet t'u bëhen vizita prodhueseve vendorë dhe bizneseve, shqyrtimin e raportit për performancën e ndërmarrjeve publike dhe vizita në këto ndërmarrje; raportet e agjencive të pavarura dhe mbikëqyrja performancën e tyre. Sa i përket Projektligjit për investimet strategjike, do ta analizojmë më shumë kujdes, deri në detaje dhe për këtë propozoi angazhimin e një eksperti të jashtëm, për t'i parë praktikën dhe defektet që mund të na paraqiten gjatë zbatimit. Po ashtu, duhet të shikojmë edhe mundësitë e nismave tjera ligjore, sepse kemi shembullin e mirë të deputetes Sala Berisha – Shala.

Besim Beqaj, tha se gjatë vitit 2015, Komisioni ka pasur në agjendë shumë aktivitete të cilat i ka përmbushur, por ajo që ka qenë në muajit e fundit të vitit, është mospjesëmarrja e opozitës në mbledhjet e Komisionit dhe konsideroi se nuk ka qenë vit i këndshëm, pa prezencën e opozitës, pra ka qenë një vit shumë sfidues. Po ashtu, i bëri ftesë publike opozitës që t'i kthehet punës në Komision. Ndërsa, sa përket orientimit për vitin 2016, kërkoi që të ketë koordinim më të madh me Qeverinë, pasi që në vitin 2015, shpesh kemi pasur projektligje, propozime dhe vendime për bordet e agjencive, që na kanë sjellë në momentin e fundit për t'i miratuar, prandaj duhet të kërkojmë që gjatë vitit 2016, këto mënyra të procedimit të shpejtë mos të ndodhin. Në vijim, kërkoi që të konsultohet Zyra Ligjore e Kuvendit, duke verifikuar

bazën ligjore dhe procedurale se a janë në rregull propozim-vendimet e Qeverisë. Për punën e vitit 2016, tha se Plani i punës së Komisionit për vitin 2016, duhet të hartohet edhe në bazë të programit legjislativ të Qeverisë. Për Projektligjin për investimet strategjike, tha se në parim e kemi votuar, por që nuk i plotëson të gjitha kushtet, andaj për këtë pajtohemi me kryetarin, që duhet të angazhohet një ekspert nga shtetet e rajonit, si p.sh. nga Kroacia. Për bizneset, tha se duhet të vazhdojmë komunikimin me ta, por duhet të shikojmë edhe interesin e qytetarëve dhe të kemi një balancim në mes të dy anëve.

Fatmir Rexhepi, tha se së pari dëshiroj që të kalojë kriza parlamentare, për të pasur normalitet të punës në Kuvend. Për orientimin e punës së Komisionit për vitin 2016, theksoi se duhet të orientohemi në 2-3 çështje kryesore, që janë në të mirë të zhvillimit ekonomik të vendit. Të kemi vizita në sektorin prodhuesve vendorë dhe t'i promovojmë më shumë edhe produktet e tyre. Sa i përket sektorit publik dhe atij privat, duhet t'i shikojmë praktikën më të mira të vendeve të rajonit, që mos ketë dallime të mëdha të subvencioneve, pasi që pothuaj të gjitha të hyrat në buxhetin e shtetit janë nga sektori privat. Ndërsa, për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, neve duhet të kemi koordinime më të shpeshta me institucionet përkatëse, për t'u njoftuar se sa po zbatohen në praktikë ligjet dhe sa po adresohen rekomandimet e Kuvendit.

Sala Berisha –Shala, falënderoi dhe përgëzoi stafin e Komisionit, që gjatë gjithë vitit 2015, më përkushtim të madh, e ka kryer punën e vet. Po ashtu, falënderoi edhe organizatën INDEP, që e ka përkrahur punën e Komisionit, mediat dhe shoqërinë civile, që kanë përcjellë punën e Komisionit gjatë vitit 2015. Më tej, theksoi se pasi që kemi shqyrtuar vetëm 4 raporte të agjencive të pavarura, edhe raportet e agjencive të cilat nuk i kemi shqyrtuar, në mungesë të bordeve, propozoj që t'i vizitojmë. Po ashtu, tha se kontrolli parlamentar duhet të jetë më i madh në mbikëqyrjen e punës së Qeverisë, me anë të monitorimit të vazhdueshëm të ligjeve. Për nismat ligjore nga Komisioni, tha se duhet të shikojmë se a ka ndonjë fushë e cila është urgjente që nuk është e mbuluar me Strategjinë legjislativë të Qeverisë, nëse jo, atëherë mund të fillojmë me nisma ligjore.

Raif Qela, foli për harmonizimin e punëve me Qeverinë, që duhet të jetë më i madh dhe i koordinuar më mirë gjatë vitit 2016. Orientimet kryesore për vitin 2016, pos fushëveprimit të madh që ka Komisioni, duhet që punën edhe aktivitetin e vet ta fokusojë te plotësimi- ndryshimi i Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara, që në këtë rast kemi të bëjmë me ndërmarrjen “Trepça”. Siç shihet, kanë nisur disa lëvizje në këtë drejtim, mirëpo ne kemi një numër të mirë të ekspertëve të brendshëm të kësaj fushe. Andaj, propozoi që fillimisht të fillohet me ekspertë të brendshëm, si dhe orientimi për çështjen e ndërmarrjes “Trepça” të jetë më shumë profesional dhe jo mediatik.

Blerim Grainca, lidhur me raportin, tha se është paraqitur një punë e madhe dhe voluminoze që ka bërë Komisioni gjatë vitit 2015, por që nuk është bërë shumë publik. Për orientimet për vitin 2016, propozoi që të rritet numri i vizitave nëpër terren dhe të kemi monitorim më të madh fushëveprimit nëpër sektorët që i mbulon Komisioni në mbikëqyrjen e rekomandimeve, të cilat i ka nxjerrë Komisioni, në një numër të madh.

Duda Balje, tha se në raport është paraqitur puna e mirë që është bërë në Komision gjatë gjithë vitit 2015. Sa përket orientimit kryesor për vitin 2016, duhet të fokusohemi në zgjedhjen e problemeve ekonomike, për të cilat duhet të punojmë shumë gjatë vitit 2016.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i punës së Komisionit për vitin 2016.

Autorizohet Njësia mbështetëse e Komisionit, që të hartojë një draft të Planit të punës për tremujorin e parë të vitit 2016, për mbledhjen e radhës.

4. Të ndryshme Çështje vijuese

a) Njoftim rreth vizitës së Komisionit në Tiranë, Shqipëri 17-18 dhjetor 2015

Kryetari, i njoftoi anëtarët e Komisionit, se Njësia për mbështetjen e Komisionit, ka përgatitur një informatë rreth vizitës në Tiranë, më datë 17-18 dhjetor 2015. Lidhur me këtë vizitë, tha se kanë qenë pothuajse të gjithë anëtarët e Komisionit. Në kuadër të kësaj vizite, është bërë shkëmbimi i përvojave dhe bashkëpunimin ndërmjet komisioneve homologe në mes të dy parlamenteve, dhe në të ardhmen, do të kemi mbledhje të rregullta me komisionin homolog të Kuvendit të Shqipërisë. Po ashtu, janë realizuar disa takime me përfaqësuesit e shtetit të Republikës së Shqipërisë, siç ishin: takimi me z. Ilir Meta- Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; z. Edmond Haxhinasto, ministër i Transportit dhe Infrastrukturës; z. Shkëlqim Cani, ministër i Financave; z. Ilir Bejtja, zëvendësministër i Energjisë dhe Industrisë dhe disa takime tjera me disa agjenci të fushës së minierave. Po ashtu, z. Mustafa potenco i se ka qenë një vizitë frytdhënëse, për çështje konkrete që dolën në mes të dy shteteve.

Sipas procedurës, njoftimi për vizitën i shpërndahej Kryesisë dhe deputetëve të Kuvendit.

b) Studime rasti lidhur me përvojat ndërkombëtare në rastin e ngjashëm me ndërmarrjen “Trepça”

Kryetari, siç e dini, në Kuvend dhe Qeveri, dhe posaçërisht në Komisionin tonë, jemi marrë në mënyrë intensive me çështjen e statusit dhe ristrukturimit të Trepçës. Lidhur me këtë çështje, ua kam dërguar një email me disa emra ekspertësh, për ta miratuar dhe përkrahur iniciativën e Kryetarit të Kuvendit. Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për ndërmarrjet publike, duhet të nxirret një ligj i veçantë për Trepçën, si dhe strategjia e zhvillimit të saj. Kjo është një çështje që duhet të kryhet sa më shpejt, sepse afati i fundit është nëntori i vitit 2016 dhe mund të vijmë në situatë të ngjashme, sikurse që ishim në fund të janarit të vitit 2015. Në Qeveri, janë duke u zhvilluar aktivitete të caktuara dhe ne presim që brenda këtij afati, dokumentet të procedohen. Në takimet që kam pasur me Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli,

lidhur me punën tonë gjatë vitit të ardhshëm, kjo është parë si një nga detyrat me prioritet, për shkak të dimensioneve të saja ekonomike, politike dhe sociale. Është shtruar nevoja që Kuvendi të jetë sa më i përgatitur, i informuar mirë dhe me një rol aktiv në këtë çështje. Jemi pajtuar se është shumë me rëndësi që të mësojmë nga përvojat e avancuara ndërkombëtare në trajtimin e rasteve të ngjashme. Prandaj, kemi propozuar që të bëhen disa studime rasti nga ekspertë, specialistë të kontraktuar, që të përgatisin studime rasti. Më pas, i paraqiti disa ekspertë të ndryshëm të kësaj fushe, që kanë një përvojë të gjatë, si: 1. prof. Iraj Hashi (Britani e Madhe); 2. Krasen Satnchev (Bullgari); 3. Erol Katricioglu (Turqi); 4. Kenet Jackson (Zelanda e Re); 5. Florian Kongoli (Kanada); 6. Mark Crawford (SHBA). Detyra e tyre projektuese është që të prezantojnë një raport mbi rastin e caktuar, me këtë përmbajtje: hyrje, konteksti me përqendrim në Trepçë; prezantimi i kompanisë (Background), që merret si rast studimi; historiku i shkurtër i asaj kompanie (që mund të shërbejë si rast mësimi për Trepçën); operacionet biznesore dhe trendet e tyre në disa vite të fundit, para transformimit dhe pas transformimit: prodhimi; investimet; tregu (kërkesa e parashikuar në vend dhe eksport); mjedisi ligjor dhe aspektet ligjore (si është adresuar ajo kompani me legjislacionin e atij vendi); aranzhmanet pronësore; qeverisja e korporatave; raportet me Kuvendin dhe Qeverinë; analiza SWOT; mësimet për Trepçën dhe konkluzionet.

Besim Beqaj, tha se në parim pajtohet për studime rasti lidhur me përvojat ndërkombëtare në rastin e ngjashëm me “Trepçën”, por që duhet të rishikohet struktura projektuese dhe detyrimet projektuese duhet të harmonizohen. Po ashtu, pajtohem që duhet të angazhohen ekspertë që kanë përvoja të ndryshme. Ne duhet të njoftojmë se cilat janë orientimet e Qeverisë dhe duhet pasur një orientim substancial.

Raif Qela, për studime rasti lidhur me përvojat ndërkombëtare në rastin e ngjashëm me “Trepçën”, së pari Qeveria duhet të na informojë se në çka do të orientohet, ta ketë të qartë se ku do të arrijë me këto objektiva. Ndërsa, nuk janë të hartuar dy dokumentet që janë bazike për gjithë kompleksin “Trepça”, ligji dhe strategjia. Po ashtu, pjesë kryesore e këtij mozaiku është që të kemi edhe angazhimin e ekspertëve të brendshëm që ka Kosova, dhe normalisht, të kemi edhe përvoja të huaja.

Sala Berisha – Shala, tha se pasi që sfida është politike, sociale dhe mjedisore, sa i përket ekspertëve, ka mjaft ekspertë të brendshëm, por që duhet të angazhohen edhe të jashtëm. Lidhur me gjithë këtë proces, duhet të ketë transparencë të plotë.

Komisioni mbështeti propozimin e Kryetarit të Kuvendit për angazhimin e ekspertëve ndërkombëtarë, për të marrë përvojat e avancuara ndërkombëtare në trajtimin e rasteve të ngjashme, siç është rasti me ndërmarrjen “TREPÇA”, sipas detyrës së propozuar projektuese.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa